

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 22 shkurt 2017

**RAPORT ME REKOMANDIME
I
MEKANIZMIT KOMBËTAR PËR PARANDALIMIN E TORTURËS I
AVOKATIT TË POPULLIT**

lidhur me vizitën në Institutin Special në Shtime

Për: Z. Arban Abrashi, ministër
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Z. Imet Rrahmani, ministër
Ministria e Shëndetësisë

Znj. Lirije Kajtazi, kryetare
Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione

Z. Xhemajl Dugolli, drejtor
Institutit Special në Shtime

Z. Naim Ismajli, kryetar
Komuna Shtime

Në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 17 të Ligjit të Avokatit të Popullit, nr.05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës i Avokatit të Popullit ka vizituar Institutin Special në Shtime (në tekstin e mëtejshëm “ISSH”)

Datat e vizitës dhe përbërja e grupit monitorues

1. Në pajtim me nenin 17 të Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L-019, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (në tekstin e mëtejshëm “MKPT”) i Avokatit të Popullit më 13 dhjetor 2016, ka vizituar Institutin Special në Shtime (në tekstin e mëtejshëm “ISSH”). Grupi monitorues përbëhej nga një juristë, një mjeke dhe një psikologe.

Përshkrimi i përgjithshëm i institucionit

2. Instituti Special në Shtime (ISSH), menaxhohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), të cilën e udhëheqë drejtori i Institutit. Është institucion i tipit të hapur i cili ofron shërbime 24 orës: ushqim, veshmbathje, përkujdesje shëndetësore, terapi të punës edukative dhe aftësuese, trajtim social. Përfitues të shërbimeve në këtë Institucion janë kryesisht personat me aftësi të kufizuara mendore -ngecje në zhvillimin mendor.
3. Kapaciteti i ISSH-së është për 64 rezidentë, ndërsa gjatë vizitës së fundit ishin prezent 59 rezidentë, prej tyre 39 të gjinisë mashkullore, 20 të gjinisë femërore, moshë mesatare e tyre është 45 vjeç.
4. Stafi i ISSH-së gjithsej janë 70 persona, të ndarë në disa shërbime si: shërbimi shëndetësor i përbërë nga: 1 mjek i përgjithshëm, 11 infermier, 1 teknik i farmacisë, 23 ndihmës mjekësor, si dhe një floktarë; shërbimi teknik i përbërë nga: 1 shef i shërbimit, 1 agjuntatorë, 4 rrobararës, 4 garda, 2 vozitës; shërbimi social i përbërë nga: 1 puntor social, 1 teknik i bujqësisë, 1 terapeut profesional, 1 instruktur artizanati, 1 instruktore e rrobaqepësisë, 1 instruktur i zdrukthëtarisë; shërbimi i kuzhinës i përbërë nga: 1 shef i shërbimit, 4 kuzhinier, 2 ndihmës kuzhinier, 2 enëlarës-servues, 1 ndihmës mjekësor; shërbimi i administratës i përbërë nga zyrtari i financave, zyrtari i personelit, zyrtari i parasë së imtë, depoisti.

Legjislacioni relevant

5. Ligji i parë për Shëndetin Mendor, nr. 05/L-025 ka hyrë në fuqi në dhjetor të vitit 2015, ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e shëndetit mendor, parandalimin e problemeve që lidhen më të, garantimin e të drejtave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për personat me çrregullime mendore. Neni 18 i këtij Ligji parasheh nxjerrjen e aktit nënligjor për trajtimin e rezidentëve që gjenden në institucionet e kujdesit social¹. Deri më tani nuk është nxjerr asnjë akt nënligjor, apo ligj i veçantë që rregullon trajtimin e rezidentëve në Institucionet e kujdesit social, të cilat menaxhohen nga MPMS dhe Komunat.
6. Këto Institucione vazhdojnë të rregullohen me dy Udhëzime Administrative të MPMS: UA nr.11/2014 për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, si dhe UA nr. 13/2010 për ofrimin e shërbimeve në komunitet- shtëpi për persona me aftësi të kufizuara mendore -ngecje në zhvillimin mendor.

¹ Neni 18, paragrafi 1 i Ligjit me Nr 05/L-025 Për Shëndetin Mendor, thekson: “Personave, që gjenden në institucionet rezidenciale të përkujdesit social, u ofrohet këshillim, trajtim, rehabilitim dhe kujdes në shëndet mendor në mënyrë të barabartë dhe sipas standardeve shëndetësore, të miratuara nga Ministra e Shëndetësisë”. Paragrafi 2 i këtij neni thotë: Mënyra e organizimit dhe e dhënies së shërbimeve, të parashikuara në paragrafin 1, të këtij neni, përcaktohet me akt të veçantë nënligjor të propozuar nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, të miratuar nga Qeveria.

7. Në bazë të UA nr.11/2014 Për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor në Institutin Special në Shtime dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, parashihet trajtimi i personave që u është marrë zotësia e veprimit nga Gjykata Themelore. MKPT i AP-së ka hetuar të gjitha rastet e rezidentëve pa vendim gjyqësor dhe në shkurt të vitit 2016 ka publikuar raportin me rekomandime.² Gjatë vizitës së datës 13 dhjetor 2016, MKPT u njoftua se rekomandimi i AP-së është implementuar nga ISSH.

Bashkëpunimi me MKPT gjatë vizitës

8. Gjatë vizitës së MKPT-së, personeli i ISSH-së i ofroi bashkëpunim të plotë ekipit monitorues. Ekipi pa vonesa pati qasje në të gjitha hapësirat ku qëndronin rezident dhe iu mundësua biseda me disa nga rezidentët me shkallë të lehtë të ngecjes në zhvillim mendor, të cilët ishin në gjendje të bisedonin.

Kushtet e jetesës së rezidentëve dhe trajtimi

9. Gjatë vitit 2016 në hapësirat e ISSH-së është ndërtuar një objekt i ri në të cilin janë vendosur administrata e këtij institucioni, ndërsa pjesa ku ka qenë administrata, është përshtatur për banim, e cila e ka lehtësuar punën e stafit dhe është mundësuar që të bëhet kategorizimi i rezidentëve sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore. Në repartin A1 ishin të vendosur kategoria e lehtë e rezidentëve, në repartin A2 kategoria e mesme dhe në repartin B kategoria e rëndë.
10. ISSH kishte edhe hapësirat e aktiviteteve, sallë për pikturim, salla për artizanate dhe rrobaqepësi si dhe salla rekreative e pajisur me mjete si: shah, domino, letra gjithashtu e kishte edhe një restorant ku në çdo kohë kanë mundësi të shërbehen me çaj rezidentët. **MKPT e vlerëson pozitivisht ristrukturimin e reparteve brenda Institucionit, si dhe kategorizimin e rezidentëve sipas gjinisë dhe gjendjes shëndetësore, i cili ofron edhe siguri për rezidentët.**
11. Krijimi i një mjedisi terapeutik pozitiv përfshinë vënien në dispozicion të hapësirës jetike të mjaftueshme për pacientë si: ndriçim, ngrohje, ajrim të përshtatshëm si dhe pastërti në nivel të kënaqshëm. Gjatë vizitës së MKPT-së në dhomat ku akomodoheshin rezidentët, kryesisht ishin 2 deri 3 shtretër në një dhomë, kishte ndriçim natyral, ishin të ngrohta dhe të pastërta, dhe ishin në pajtim me nenin 6, paragrafi 1.10 të Ligjit Për Shëndetin Mendor, nr.05/L-025.³
12. Sipas standardeve të Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, vëmendje duhet t'i kushtohet edhe dekorimit të dhomave të pacientëve dhe mjediseve të argëtimit, për t'u dhënë pacientëve stimulim pamorë, gjithashtu vënia në dispozicion e komodinave pranë krevatit dhe garderobave është shumë e dëshirueshme. Gjatë vizitës së MKPT-së, në dhomat e rezidentëve kishte komoda për vendosjen e rrobave dhe gjërave personale, gjithashtu kishte edhe dekorime për stimulim pamorë p.sh piktura të ndryshme, të cilat janë punuar nga disa rezidentë në bashkëpunim me instruktorët.

² Raport Ex-Officio: 757/2015 lidhur me vendimet gjyqësore për heqjen dhe kthimin e zotësisë për të vepruar, rezidentëve në ISSH dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, shih në:

http://ombudspersonkosovo.org/repository/docs/150-2016_Raport_me_rekomandime_875017.pdf

³Neni 6, paragrafi 1.10 i Ligjit Nr.05/L-025 Për Shëndetin Mendor, përcakton “të drejtën për t'u siguruar kushtet e përshtatshme jetësore, higjienike, të ushqyerjes dhe sigurisë”

13. Gjithashtu, MKPT u njoftua që në ISSH është duke funksionuar lavaxteria 24 orë, e cila ishte e pajisur me tri makina për larje, tri makina për tharjen e rrobave si dhe hekuri për hekurosje të rrobave, e çarçafëve. **Dhe kjo tani u ka lehtësuar edhe çështjen e veshmbathjes, pasi që personeli i institucionit kanë mundësi që me kohë të ju pastrojnë rrobat dhe mos të ju ndërrohen rrobat e rezidentëve, pra secili t'i kenë veshmbathjet personale.**

Kuzhina, ushqimi

14. Gjatë vizitës në ISSH, ekipi i MKPT-së ka vizituar edhe kuzhinën ku përgatitet dhe servohet ushqimi. Kuzhina kishte ndriçim dhe ventilim të duhur, pastërtia ishte në nivel. Gjithashtu, stafi i kuzhinës posedonin edhe librezat sanitare.
15. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës rëndësi të veçantë i kushton edhe ushqimit të pacientëve, ku sipas tyre, ushqimi jo vetëm që duhet të jetë i përshtatshëm nga pikëpamja e sasisë dhe cilësisë, por edhe të jepet në kushte të kënaqshme⁴. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se Instituti është furnizuar mirë dhe me rregull me ushqim, e kanë mbjellë edhe serën me perime e cila shfrytëzohet për ushqim dhe mirëmbahet nga stafi dhe një rezident. Ushqimi përgatitet sipas menysë dhe jepet në tri shujta.
16. MKPT u njoftua se Instituti në Shtime furnizohet rregullisht me ujë të pijshëm, si dhe i kanë hapur tri puse të ujit në mënyrë që të sigurojnë rezerva në rast se ka ndonjë problem me ujë. Gjithashtu, ISSH kishte kontratë të rregullt për realizimin e shërbimit 3D (Dezinfektim, Dezinsektim, Deratizim). **Gjatë vizitës, MKPT nuk ka hasur në ushqime me afate të skaduar. MKPT përshëndet angazhimin e stafit të ISSH-së për kujdesin dhe higjienën në përgjithësi.**

Trajtimi

17. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, trajtimi psikiatrik duhet të bazohet në një përjasje të individualizuar, gjë që nënkupton hartimin e një plani të trajtimit për çdo pacient, i cili plan duhet të përfshijë aktivitete rehabilituese dhe terapeutike, duke përfshirë psikoterapi individuale, terapi në grup, art, teatër, muzikë dhe sporte. Pacientët duhet të kenë qasje të rregullt në dhoma argëtimi të pajisura përshtatshëm dhe të kenë mundësi të bëjnë ushtrime ajrimi në qiell të hapur⁵.
18. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se në ISSH, aktivitetet psiko-sociale i kanë të avancuara, për shkak të mundësive infrastrukturore dhe numrit të stafit për realizimin e aktiviteteve rekreative dhe terapisë okupacionale, i kanë të angazhuar terapeutët profesional dhe realizojnë aktivitete si pikturim, rrobaqepësi, punë dore prej druri, si dhe lojra të ndryshme (shah, domino, letra, etj). Sipas stafit të Qendrës, rreth 15 deri 20 rezidentë janë aktiv në punëtoritë si: rrobaqepësi, zdrukthëtari dhe në pikturë. Gjithashtu si aktivitet që rregullisht e bëjnë janë edhe ekskursionet gjatë vitit, p.sh dalje në natyrë, shëtitje në ndonjë qytet turistik.
19. MKPT u njoftua se ISSH ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me kolegjin privat "HEIMERER" i cili zhvillon programe bachelor në fushën e shëndetësisë si: Infermieri, Logopedi, Ergoterapi, Pedagogji Profesionale në Shëndetësi. Studentët e këtij kolegji kanë filluar të mbajnë praktikën 6 mujore në ISSH dhe kjo iniciativë e ndihmon stafin e ISSH-së në realizimin e aktiviteteve si dhe në vazhdimësi do ta avancojë edhe më shumë

⁴ Normat e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm.

⁵ Po aty.

fushën psiko-sociale në këtë Institucion të kujdesit social. **MKPT përshëndet angazhimin e stafit për zhvillimin e fushës psikosociale dhe përkushtimin e tyre ndaj rezidentëve.**

Kujdesi shëndetësor

20. Në ISSH është angazhuar mjeku i përgjithshëm i rregullt, një psikiater një herë në javë ndërsa shërbimet stomatologjike i marrin nga Shtëpia për të moshuar në Prishtinë. Në rast nevojë, shërbimet tjera shëndetësore dhe specialistike u ofrohen nga Qendra e Mjekësisë Familjare në Shtime, Spitali Rajonal në Ferizaj dhe Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Për dallim prej institucioneve tjera rezidenciale të shëndetit mendor, ISSH gjatë vitit 2016 i ka realizuar edhe vizitat e rregullta gjinekologjike të rezidentëve. Gjithashtu gjatë vitit 2016, në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Shtime, rezidentëve u janë bërë edhe analizat laboratorike. Sa i përket furnizimit me barna, nuk kishte asnjë ankesë nga stafi i ISSH-së.
21. Ambulanca ku qëndronte personeli shëndetësor, nuk i plotësonte kushtet për shkak të hapësirave të vogla dhe të papërshtatshme, nuk ka ndriçim të mjaftueshëm. **MKPT konstaton se hapësira që shfrytëzohet për shërbime shëndetësore, nuk i plotëson kushtet minimale për ofrimin e këtyre shërbimeve.**
22. Sa i përket trajnimeve për stafin, drejtori i ISSH-së, ka bërë marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën e Mjekësisë Familjare në Shtime dhe Spitalin Rajonal të Ferizajt, për edukim të vazhdueshëm të personelit shëndetësor të ISSH-së.
23. Në ISSH, i kishin disa regjistra si: regjistri i vizitave neuropsikiatrike, i vizitave jashtë ISSH-së, i infeksioneve, i lidhjes së plagëve, i shqetësimeve, sterilizimeve, mirëpo mungonte regjistri i vdekjeve, tentim vetëvrasjeve, lëndimeve, vetëlëndimeve. **MKPT inkurajon stafin shëndetësor t'i kushtojnë rëndësi dosjeve të rezidentëve si dhe evidentimit në regjistra të veçantë të rasteve të vetëlëndimeve, lëndimeve trupore, tentim vetvrasjes, vdekjeve dhe rasteve kur përdoren mjetet e kufizimit.**

Keqtrajtimi

24. Gjatë vizitës së MKPT-së në Qendër, vërehej një klimë pozitive dhe marrëdhënie të mira mes rezidentëve dhe stafit. Pra, **MKPT nuk ka evidentuar asnjë rast të torturës apo keqtrajtimit nga stafi ndaj personave me aftësi të kufizuara mendore-ngecje në zhvillimin mendor.**
25. Gjatë vizitës, MKPT ka vërejtur që brenda rrethojave të Institucionit kishte qenë endacak, të cilët mund të paraqesin rrezik për rezidentët. **MKPT rekomandon që të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e ISSH-së.**

Mjetet e kufizimit

26. Sipas Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës, kufizimi i pacientëve të axhituar ose të dhunshëm duhet të jetë, sa më shumë që është e mundur, jo fizik (p.sh instruksion gojor) dhe që aty ku është i nevojshëm kufizimi fizik, ai në parim duhet të kufizohet në kontroll me duar. Gjatë vizitës së MKPT-së, u intervistuan edhe stafi lidhur me çështjen e mjeteve kufizuese në raste të krizave, ku sipas tyre, rezidentët zakonisht janë të qetë dhe nuk ka nevojë të përdoren mjete kufizuese.

Kontakti me botën e jashtme

27. Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës, thekson se mbajtja e kontakteve me botën e jashtme është thelbësore jo vetëm për parandalimin e keqtrajtimit por edhe nga një pikëvështrim terapeutik⁶.
28. Personave që u hiqet zotësia e veprimit me vendim të gjykatës, u caktohet kujdestari ligjor nga Qendra për Punë Sociale (QPS) apo jashtë QPS-së. Neni 9 i UA nr. 11/2014 Për punën dhe vendosjen e rezidentëve, personave me aftësi të kufizuara mendore- ngecje në zhvillimin mendor, në ISSH dhe në shtëpitë me bazë në komunitet, thekson: *“Kujdestari ligjorë jashtë QPS-së apo nga QPS-ja, ka të drejtën ligjore të tregoj interesim për rastin e strehuar në ISSH apo në shtëpi me bazë në komunitet pa u penguar nga askush”*. Gjatë vizitës, MKPT u njoftua se shumica e rezidentëve janë pa përkujdesje familjare, por edhe rastet që kanë familje u mungon interesimi për t’i vizituar. Gjithashtu edhe kujdestarët e tyre ligjor nuk i vizitojnë rregullisht rezidentët e vendosur në ISSH.

Procedura e parashtrimit të ankesave

29. Institucioni i Avokatit të Popullit i ka vendosur kutitë e ankesave, të cilat mund të hapen vetëm nga personeli i këtij institucioni, gjë që për familjarët e rezidentëve ofron konfidencialitet në parashtrimin e ankesës. Rezidentët me ngecje në zhvillimin mendor të vendosur në ISSH, nuk janë në gjendje të parashtrojnë ankesa. **MKPT nuk ka pranuar asnjëherë ankesa nga stafi apo familjarët e rezidentëve të vendosur në ISSH.**

Në bazë të të gjeturave dhe konstatimeve të arritura gjatë vizitës, në pajtim me nenin 135 paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 16 paragrafi 4 i Ligjit për Avokatin e Popullit, nr. 05/L019, Avokati i Popullit rekomandon:

Ministrinë e Shëndetësisë dhe MPMS

- Të nxirren aktet nënligjore në pajtim me nenin 18, paragrafi 2 i Ligjit për Shëndetin Mendor, nr. 05/L-025.

Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

- Të sigurohen kushtet (hapësirat) adekuate për punën e personelit shëndetësor.


Institutin Special në Shtime

- Të krijohen regjistra të veçantë të rasteve të vetëlëndimeve, lëndimeve trupore, tentim vetëvrasjes, vdekjeve dhe rasteve kur përdoren mjetet e kufizimit.

Komuna e Shtimes

- Të merren masat për evitimin e problemit të prezencës së qenve endacak në oborrin e Institucionit.

Me nderime,


Hilmi Jashari

Avokat i Popullit

⁶ Standardet e Komitetit Evropian për Parandalim të Torturës, Pjesë nga Raporti i 8-të i Përgjithshëm [CPT/Inf (98) 12], *Garanci gjatë vendosjes*, paragrafi 54